



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurrenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.26/24
Datë: 13.03.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 13.03.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e 100% të kapitalit aksionar nga Ken BidCo (blerës) mbi Kin and Carta (targeti).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë, 20.02.2024, me Nr. Prot. 42/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me blerjen e 100% të kapitalit aksionar nga Ken BidCo Limited (blerës), mbi Kin and Carta (targeti).

Procedurat e ndjekura

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 16.02.2024
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit, në web faqen e AKRK-së më datë 20.02.2024
3. Palët në Përqendrim kanë lidhur Marrëveshje për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 19.12.2023.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Palët kanë lidhur Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 19 Dhjetor 2023.

Ken BidCo Limited, është kompani private me përgjegjësi të kufizuar e inkorporuar në Angli Uells, me seli në 10-14 White Lion Street, Londër, Mbretëria e Bashkuar, N1 9PD, me numër të biznesit 15336357. Kompania direkte amë është Turing Lux Bidco 2 S.a.r.l., e cila është edhe kompania amë e Grupit Valtech. Turing Lux 2 është në pronësi dhe kontroll të fondit BC Partners XI. BC Partners është kompani ndërkombëtare investuese në menaxhim dhe strategji të kapitalit privat neto, kredive private dhe patundshmërive.

BC Partners nuk ka filiale apo degë të regjistruar në Kosovë, mirëpo filialet e BC Partners kanë kontroll indirekt mbi një filial në Kosovë, kompaninë Promedia Sh.p.k., e cila ofron shërbime të marketingut për konsumatorët në Kosovë.

Kin and Carta, me seli në The Spitfire Buildings, 71 Collier Street Londër Angli, N1 9BE, me numër të biznesit 01552113. Kin and Carta është kompani globale konsulente për transformimin digjital, e cila mes tjerash u shërben bizneseve nga fushat e sektorit shëndetësor, shërbimeve financiare, industrisë dhe bujqësisë, shitjes me pakicë dhe distribucionit, transportit, sektorit publik etj.

Tregu përkatës:

Tregu i produktit: tregu i shërbimeve, të IT-teknologjisë informative.

Tregu gjeografik: konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Analiza e konkurrencës

Transaksioni i propozuar, nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh që transaksioni nuk rezulton në asnjë mbivendosje horizontale ndërmjet palëve në tregun e Kosovës, për arsye se Ken BidCo nuk ofron shërbime të IT-së në Kosovë, që domethënë se palët nuk veprojnë në treg të njëjtë të produktit. Kjo kompani është krijuar posaqërisht për qëllime të transaksionit dhe nuk ka realizuar veprimtari që nga themelimi i saj. Transaksioni nuk ngritë asnjë shqetësim për konkurrencën, pavarësisht përcaktimit të saktë të tregut në Kosovë.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë, për arsye se Filialet e BC Partners kanë kontroll indirekt mbi kompaninë Promedia, filial i United Group i regjistruar në Kosovë, që është kompani e portofolit të BC Partners. Kompania Promedia, ofron shërbime marketingu për konsumatorët në Kosovë. Blerësi është prezent në territorin e Republikës së Kosovës, respektivisht përmes filialit të tij Kin and Carta Kosovo SH.P.K., e cila kryen aktivitete të programimit kompjuterik dhe

aktivitete të tjera të teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve kompjuterike në Kosovë. Duke pasur parasysh që tregu në Kosovë është mjaft konkurrues tek shërbimet e IT, pasi që kemi një numër të madh të kompanive që kryejnë këto shërbime, prandaj ky treg nuk është treg i koncentruar dhe si i tillë nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën dhe konsumatorët në Republikën e Kosovës.

Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të ketë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Sekretariati ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion/blerja nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Propozim Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva